

VENDIM
I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
“HEC-i TËRVOLIT” SHPK

Sot, më datë 1.12.2023, bazuar dhe në zbatim të statutit të shoqërisë dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), u thirr dhe u mbajt në Hotel Skapma, Elbasan, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “HEC-i TËRVOLIT” SHPK -, mbledhje e thirrur nga Administratori i shoqërisë në përputhje me nenin 83, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008.

Të pranishëm në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme janë të gjithë ortakët që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

- Shoqëria “BLE – KLO – AR” SHPK, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 38,43% të kapitalit të shoqërisë e përfaqësuar nga administratori Bledar Mehmeti;
- Shoqëria “SKRAQI” SHPK, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 34,20% të kapitalit të shoqërisë e përfaqësuar nga z. Julian Skraqi;
- Z. Refat Mustafaraj, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 14,50% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Olset Haxhiu, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 8,37% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Bashkim Spahiu, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 4,5% të kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme mori në shqyrtim çështjen e mëposhtme të rendit të ditës:

- Miratimin në parim për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Hec-i Tërvolit” SHPK”.
- Caktimin e z. Rubin Qenani, ekspert kontabël i autorizuar, për hartimin e aktit të ekspertimit për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës dhe dokumentacionin e nevojshëm, me unanimitet:

VENDOSI


1. Miratimin në parim për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Hec-i Tërvolit” SHPK, në shumën 80,000,000 (Tetëdhjetë milion) lekë.
2. Kalimin e shumës që do të zvogëlohet në zërin e bilancit (pasqyrave financiare) “Rezerva të Tjera” me qëllim përdorimin e shumës së zvogëluar për shpërndarjen e dividendit tek ortakët e shoqërisë.
3. Caktimin e z. Rubin Qenani, ekspert kontabël i regjistruar me numër licence 486, datë 04.11.2021, si ekspert për hartimin e raportit të zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë dhe përcaktimin e shumave të dividendit për secilin ortak.
4. Ngarkohet administratori i shoqërisë për vënien në dispozicion të ekspertit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, për hartimin e këtij akti ekspertimi dhe depozitimin e këtij vendimi në autoritetet përkatëse shtetërore.

ORTAKËT

SHOQËRIA “BLE-KLO-AR” SHPK

SHOQËRIA “SKRAQI” SHPK



Heci Tervolit sh.p.k.
Fshati Pishaj Gramsh
Nipt K73621202N
Cel.00355682081514
E-mail: info@hecitervolit.com
Web: www.hecitervolit.com


BLE - KLO - AR
SHPK
ELBASAN ALBANIA
Bledar Mehmeti
Julian Skraqi
Refat Mustafaraj
Olset Haxhiu
Bashkim Spahiu

REFAT MUSTAFARAJ

OLSET HAXHIU

BASHKIM SPAHIU

Dojot Haxhiu 
Olset Haxhiu 

Bashkim Spahiu 